

27 prill 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të datës 30.08.2023, si dhe në trajtim të kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të datës 17.04.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), me datë 27.04.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. SHQIPTOHET dënim ndalesë loje në terrenin e vet për një (1) ndeshje ndaj klubit KBF Bashkimi, për shkelje të lehtë disiplinore sipas Nenit 48(2)(b) të Rregullores Disiplinore të FBK-së, për veprime që tregojnë mungesë respekti ndaj një anëtarit të ekipit, një tjetër individi, apo çdo person tjetër, e që nuk përbën një shkelje të rëndë;
- II. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit do të zbatohet në edicionin e ardhshëm të garave të Superliga Femrat.

A R S Y E T I M

Më datë 17.04.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), përmes postës elektronike, ka pranuar kërkesën nga KBF Peja 03 për inicim të procedurës disiplinore ndaj zyrtarëve të KBF Bashkimi (tash e tutje “Kërkesa”), lidhur me ngjarjet gjatë ndeshjes së serisë finale mes KBF Bashkimi dhe KBF Peja 03, e zhvilluar me datë 12.04.2026 në palestrën ‘Sezai Surroi’ në Prizren.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, KD, me qëllim që menjëherë të fillojë me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, ka autorizuar administratën e FBK-së që, në përputhje me Nenin 38 të Rregullores Disiplinore të FBK-së (“RRD”), të kërkojë deklarata me shkrim nga zyrtarët e KBF Bashkimi lidhur me rrethanat e rastit.

Më datë 24.04.2026, KD ka mbajtur takimin e parë shqyrtues. Materialet, provat dhe dokumentacioni relevant i rastit kanë qenë paraprakisht në dispozicion të Komisionit për analizë.

Sipas kuptimit të KD, në kërkesën e parashtruar nga KBF Peja 03 kërkohet inicimi i procedurës disiplinore për shkelje të rënda disiplinore, përfshirë cenimin e integritetit të garës, dështimin në garantimin e sigurisë, sjellje diskriminuese dhe ndërhyrje fizike ndaj personit zyrtar, si dhe identifikimi dhe konstatimi i përgjegjësisë disiplinore individuale dhe institucionale, përfshirë zyrtarët e KBF Bashkimi dhe anëtarin e Bordit të FBK-së, z. Rrahman Përteshi. Po ashtu, kërkohet

vlerësimi i përgjegjësive së organizatorit, trajtimi *ex officio* i rastit dhe sigurimi i trajtimit të barabartë dhe proporcional të tij.

Në funksion të trajtimit të lëndës, KD ka analizuar të gjitha provat në dispozicion dhe rregullativën përkatëse, dhe ka konstatuar si në vijim.

Nga shqyrtimi i përgjithshëm i provave, KD ka konstatuar se gjatë ndeshjes ka pasur tensione të vazhdueshme, të cilat kanë filluar më herët gjatë lojës dhe janë përshkallëzuar si pasojë e reageimeve dhe provokimeve nga persona të lidhur me të dy ekipet. Po ashtu, është evidentuar hyrja në parket e personave të paautorizuar, si dhe përfshirja e tyre aktive në situatë.

Sa i përket momentit të kontaktit fizik të paraqitur në incizime (vendosje e dorës në fytyrë të trajnerit të KBF Peja 03), pas analizës së kujdesshme të materialit video, KD konstaton se ky veprim nuk mund t'i atribuohet z. Rrahman Përteshi dhe, në mungesë të identifikimit të qartë të kryerësit, nuk mund të përcaktohet përgjegjësi individuale për këtë veprim. Megjithatë, KD vlerëson se një sjellje e tillë përbën ndërhyrje të papranueshme fizike në kontekstin e ndeshjes dhe nuk është në përputhje me standardet e sjelljes sportive.

Në lidhje me pretendimet për përdorim të shprehjeve me përmbajtje diskriminuese, KD thekson seriozitetin e tyre, por konstaton se nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme që do të mundësonin vërtetimin e një shkeljeje të tillë në rastin konkret.

Në vlerësimin juridik të rastit, KD konstaton se veprimet e ndodhura, të marra në tërësinë e tyre, përbëjnë sjellje që bien në fushëveprimin e shkeljeve të lehta disiplinore sipas Nenit 48 paragrafi 2 të Rregullores Disiplinore të FBK-së.

Megjithatë, për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme për identifikim individual të kryerësve të veprimeve përkatëse, KD vlerëson se përgjegjësia disiplinore në këtë rast duhet të trajtohet në nivel të organizimit të ndeshjes, përkatësisht në nivel të klubit si subjekt përgjegjës për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e saj.

Gjatë përcaktimit të masës disiplinore, KD ka marrë parasysh rrethanat ndikuese në kuptim të Nenit 23 të RRD, duke i dhënë peshë të veçantë sjelljes së të dy palëve gjatë ndeshjes, si faktor kontribuues në eskalimin e situatës. Po ashtu, KD merr parasysh se veprimet e lidhura me hedhjen e gjësendeve në fushë dhe hyrjen e personave jozyrtarë në fushë, të parashikuara në nenet 51.4 dhe 51.13 të Propozicioneve të Garave, janë trajtuar dhe sanksionuar nga Komisioni i Garave, çka përbën element relevant në vlerësimin e përgjegjësive në këtë procedurë.

Këto rrethana janë vlerësuar si elemente me ndikim të drejtpërdrejtë, duke u marrë parasysh në mënyrë kumulative me provat e tjera në dosje dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Nga të gjitha rrethanat e konstatuara, KD ka ardhur në përfundim se organizimi i ndeshjes ka qenë i dobët, duke reflektuar mungesë kontrolli të hyrjeve në parket dhe dështim në menaxhimin e situatës.


Në këtë drejtim, KD ka aplikuar Nenin 49, paragrafi 2.2, pika (c) të RRD, i cili parasheh ndalesën e zhvillimit të ndeshjeve në terrenin e vet për një numër të caktuar të ndeshjeve, masë e cila shqiptohet ndaj klubit kur incidenti lidhet me organizimin e ndeshjes dhe veprimet e personave të lidhur me të.

Duke marrë parasysh përfundimin e edicionit aktual të garave, KD ka vendosur që masa e shqiptuar të bartet për zbatim në edicionin vijues, përkatësisht në ndeshjen e parë si vendas të KBF Bashkimi në Superligën Femrat.


KD thekson se përmes këtij vendimi synohet të forcohet përgjegjësia e klubeve për organizimin e ndeshjeve dhe të parandalohet përsëritja e incidenteve të ngjashme. Në rast të përsëritjes së shkeljeve të tilla, do të shqiptohen masa më të rrepta disiplinore në përputhje me Rregulloren Disiplinore.

Bazuar në të gjitha si më sipër, Komisioni Disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor:



Afrim Kamishi
Anëtar



Omer Daku
Kryetar



Blerim Vuniqi
Anëtar

Prishtinë, 27 prill 2026

Vendimi i dërgohet:

- KBF Peja 03
- KBF Bashkimi
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor
- Komisionit të Garave
- Arkivit të FBK-së



Këshilla Juridike:

Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën prej 300€, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.